



A.nr.672/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.672/2026, të datës 19.06.2026, të parashtruar nga ankuesi I.T, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.672/2026, e datës 19.06.2026 e parashtruar nga ankuesi I.T.

A r s y e t i m

Ankuesi I.T, (në tekstin e mëtejshëm referuar: Ankuesi), me datë 19.06.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 05-1339.2 të datës 16.06.2026, të u.d Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.06.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 29.06.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 2771/2026 të datës 19.06.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Përgjigjen në kërkesë e datës 16.06.2026 nga U.D Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë; Vendimin A.nr.500/2026 të KPMSHCK-së; Kërkesën me numër protokolli 05-364 të datës 02.03.2026 të parashtruar nga ankuesi tek Ud. Sekretari i Përgjithshëm i MSH; Kërkesën e datës 22.04.2024 e parashtruar nga ankuesi tek Sekretari i Përgjithshëm i MSH; Listën e Inspektorëve të Regjionit të Gjilanit, Prizrenit. Pejës, Ferizajt, Mitrovicës, Prishtinës; Zarfin e datës 28.04.2026; Kërkesën

për përgjigje në ankesë e datës 23.06.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 29.06.2026; Akt emërimit e datës 31.01.2013 të ankuesit; Memorandumin e mirëkuptimit për transferimin e Inspektorëve Sanitar i datës 12.10.2023; Listën e pagave për ankuesin maj 2026; Vendimin me Nr. 91/VI/2025 i datës 30.06.2025 i Zëvendësministrit të Ministrisë së Shëndetësisë; Akt Emërimit e datës 26.03.2026 të A.A në pozitën Inspektor Sanitar dhe listën e pagave për muajin maj 2026; Akt Emërimit e datës 22.03.2024 të A.S në pozitën Inspektor Farmaceutik dhe listën e pagave; Akt Emërimit e datës 11.04.2024 të A.K në pozitën Inspektor Shëndetësor dhe listën e pagave; Kërkesën për miratim të shtesave në pagë me numër protokolli 05-3910 të datës 22.05.2025; Vendimin e datës 22.04.2025 për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e ligjshmërisë së shtesave për kushte të tregut të punës dhe marrëveshjeve për punë me vëllim të shtuar; Plani i datës 16.01.2024 nga ora 18:30; Pallni i datës 16.02.2024; Plani i datës 17.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 18.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 19.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 23.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 24.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 25.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 26.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 29.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 30.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 31.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 09.01.2024 nga ora 19:00; Plani i datës 10.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 05.02.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 02.02.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 11.01.2024 nga ora 19:30; Plani operativ i datës 12.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 12.02.2024; Plani i datës 14.02.2024; Plani i datës 15.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 15.02.2024.

Kolegji i Këshillit pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale, ka konstatuar se ankesa është e pabazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 31.01.2013, mban pozitën Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Sanitar, fillimisht në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, mirëpo sipas Memorandumit të Mirëkuptimit për Transferimin e Inspektorëve Sanitar të datës 12.10.2023 të lidhur mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Inspektorët Sanitar janë transferuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe atë nga data 01.11.2023.

Ankuesi, më datë 03.03.2026 përmes kërkesës me numër protokolli 05-1339 i është drejtuar u.d Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, me kërkesë për nivelimin e koeficientit, zbatimin e shtesave sipas rregulloreve në fuqi dhe kompensimin e orëve shtesë për Inspektoratin Sanitar, mirëpo sipas provave të lëndës, nuk ka marr përgjigje në kërkesën e tij.

Kundër heshtjes administrative, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se janë duke u dëmtuar duke kërkuar, nivelimin e koeficientit të të gjithë Inspektorëve Sanitar dhe Kryeinspektorit Sanitar me drejtuesit e tjerë të nivelit qendror, zbatimin e shtesës prej 250 Euro në mënyrë retroaktive nga janari 2024, Kompensimin e orëve shtesë të realizuara, Rishqyrtimin e gradimit dhe kategorizimit të pozitës sipas përgjegjësi dhe rimbursimin retroaktive të diferencës së koeficientit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.05.2026, ka nxjerr Vendim me numër A.nr.500/2026, me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë të shqyrtoj kërkesën e datës 03.03.2026 të ankuesit.

Ushtuesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, më datë 16.06.2026, përmes përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 05-1339/2, ka njoftuar ankuesin se koeficienti i pagës është në pajtim me akt emërimit dhe deri në ndonjë rast të riorganizimit apo sistemimit të institucionit nuk mund të ndryshohet pozita e as koeficienti, lidhur me koeficientet e inspektorëve sanitar kjo është përcaktuar me Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ku është përcaktuar koeficienti 7, ndërsa për Inspektorët Shëndetësor dhe Farmaceutik është përcaktuar koeficienti 7.4. Sa i përket shtesave në pagë sipas kërkesës së datës 22.05.2025 rasti është proceduar te Komisioni për kushtet e tregut të punës, ku sipas kërkesës është konstatuar se kuadër deficitar i cili është problem të rekrutohet dhe të ruhet stafi janë kategoritë me kualifikim: Mjekë, Stomatolog, Farmacistë dhe Teknologji Informativë, dhe është propozuar që vetëm të punësuarit që kanë këto kualifikime të ju aprovohet shtesa, ndërsa kategoritë të tjera të largohen nga lista dhe sipas informacioneve komisioni qeveritar ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe jeni në pritje të vendimit nga Ministri i Financave.

Ankuesi, kundër kësaj përgjigjeje ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se me rastin e përgjigjes në kërkesë të datës 16.06.2026, nuk është analizuar fare fakti se pozita ime si Kryeinspektor/Udhëheqës në Inspektoratin Sanitar, ushtronë përgjegjësi menaxheriale, koordinuese, dhe mbikëqyrëse në nivel qendror, të krahasueshme me pozitën tjetër udhëheqëse në Ministrinë e Shëndetësisë. Pretendon se Inspektorët Sanitar trajtohen ndryshe me paga nga Inspektorët Farmaceutik dhe Inspektorët Shëndetësor dhe kjo nuk është trajtuar në mënyrë ligjore dhe janë shkelur parimet ligjore. Sa i përket shtesës prej 250 Euro nuk është shqyrtuar në mënyrë të drejtë sepse nuk sqarohet nëse kërkesa është aprovuar apo refuzuar. Nuk është shqyrtuar kërkesa për kompensimin e orëve shtesë. Nuk është shqyrtuar kërkesa për ri klasifikim të pozitës sime dhe kjo nuk është bërë. Kërkon që të konstatohet se nuk është zbatuar Vendimi A.nr.500/2026 i KPMSHCK-së; Të konstatohet se nuk janë shqyrtuar të gjitha pikat e kërkesës; Të urdhërohet Ministria e Shëndetësisë që të jap përgjigje konkrete dhe të argumentuar për secilin pretendim të paraqitur në kërkesë.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se pozita e tij Udhëheqës në Inspektoratin Sanitar, nuk është klasifikuar në mënyrë të drejtë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 31.01.2013, mban pozitën Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Sanitar, fillimisht në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, mirëpo sipas Memorandumit të Mirëkuptimit për Transferimin e Inspektorëve Sanitar të datës 12.10.2023 të lidhur mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Inspektorët Sanitar janë transferuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe atë nga data 01.11.2023, dhe për rrjedhojë pozita e tij sipas akt emërimit konsiderohet pozitë e kategorisë së ulët drejtuese, në këtë aspekt Kolegji ju referua dispozitave ligjore gjegjësisht nenit 38 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, ku përcaktohet se: "2. Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtorin/i në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtorin/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtorin/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitën e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitën e barasvlershme me të; 2.3. **Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqës/it të divizionit dhe pozitën e barasvlershme me të;** 2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrarët profesional, dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku përcaktohet: **Klasat përbërëse të kategorisë së ulët drejtuese dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Drejtues i Ulët 1. Udhëheqës i Divizionit në Zyrën e Kryeministrit; 2. Udhëheqës i**

Divizionit në një Ministri; 3. Udhëheqës i Divizionit në Agjenci të Pavarur; 4. Udhëheqës i Divizionit në Agjenci të Pavarur dhe në Agjenci Rregullatore; 5. Udhëheqës i Divizionit/Sektorit në Agjenci Ekzekutive dhe Komuna, si dhe shtojcës, Nr. 1/3 të kësaj rregulloreje, ku përcaktohet: Në këtë klasë vendoset Udhëheqësi i një Divizioni i cili është përgjegjës për fushën e caktuar të përgjegjësisë brenda Departamentit ose institucionit. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës civil i cili për punën e tij i përgjigjet drejtpërdrejtë Drejtorit të Departamentit ose udhëheqësit më të lartë administrativ. Përfshin pozitat me këto emërtesa: 1. Udhëheqës i Divizionit në Zyrën e Kryeministrit; 2. Udhëheqës i Divizionit në një Ministri; 3. Udhëheqës i Divizionit në Agjenci të Pavarur; 4. Udhëheqës i Divizionit në Agjenci Rregullatore; 5. Udhëheqës i Divizionit/Sektorit në Agjenci Ekzekutive dhe Komuna”, e mbi këtë bazë ligjore Kolegji i Këshillit, konstaton se pozita e ankuesit është e klasifikuar si pozitë e kategorisë së ulët drejtuese.

Tutje Kolegji i Këshillit, mori parasysh edhe Ligjin Nr.08/L-067 për Inspektimet, konkretisht nenin 2 paragrafi 1, 2 dhe 3, ku përcaktohet: “1. Ky ligj zbatohet për të gjitha funksionet e inspektimit në kompetencë të administratës shtetërore dhe komunave në Republikën e Kosovës, përveç: 1.1. inspektimit doganor dhe tatimor; 1.2. inspektimit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit; 1.3. inspektimit të brendshëm me karakter administrativ në administratën shtetërore dhe komunale; 1.4. inspektimet nga Inspektorati Policor; 1.5. inspektimet për siguri publike në kuadër të ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme. 2. Ligji i posaçëm që rregullon inspektimin në një fushë të caktuar mund të përcaktojë dispozita specifike për aspekte të ndryshme të procedurës së inspektimeve; 3. Ligji i posaçëm duhet të jetë në përputhje me parimet dhe procedurat e përgjithshme të përcaktuara në këtë ligj, si dhe nuk mund të tkurrë nivelin e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave juridike të subjektit të inspektimit të përcaktuara në këtë ligj”, ndërsa sipas shtojcës së këtij ligji, gjegjësisht Lista e inspektorateve qendrore dhe njësive të veçanta inspektuese, janë përcaktuar Inspektoratet Qendrore, e ku sipas pikës 1.3, është paraparë Inspektorati Qendror i Shëndetësisë, në kuadër të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, i cili është përgjegjës për: “1.3.1. inspektimet e institucioneve dhe profesionistëve shëndetësorë; 1.3.2. inspektimi i prodhuesve, importuesve, qarkulluesve me shumice dhe pakicë të produkteve medicinale, pajisjeve medicinale dhe profesionistëve farmaceutik; **1.3.3. inspektimet sanitare që kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit publik**; 1.3.4. inspektimet e preparateve vitaminoze, dietale dhe kozmetike me veprim terapeutik”. Në kuadër të kësaj, Zëvendësministri i Ministrisë së Shëndetësisë, më datës 30.06.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. 91/VI/2025 për Inspektoratin Qendror të Shëndetësisë, ku përveç përgjegjësisë të përcaktuar sipas Ligjit Nr.08/L-067 për Inspektimet, në pikën II të këtij vendimi është përcaktuar se *të gjithë udhëheqësit e njësive përkatëse i përgjigjen Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendror të Shëndetësisë*, kurse sipas Vendimit me Nr.10/260 të datës 29.05.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është emëruar Kryeinspektori në Inspektoratin Qendror të Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë. Rrjedhimisht sipas rregulativës ligjore si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Inspektorati Sanitar, hyn në kuadër të Inspektoratit Qendror të Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe rrjedhimisht ankuesi nga pozita e Udhëheqësit të Sektorit të Inspektoratit Sanitar, i përgjigjet Kryeinspektorit në Inspektoratin Qendror të Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë, në këtë drejtim, pozita e ankuesi paraprakisht ka qenë e klasifikuar si pozitë e kategorisë së ulët drejtuese dhe e njëjta ende e ka këtë klasifikim si për nga rëndësia po ashtu edhe për nga paga, e në këtë rast konsiderohet edhe pozitë drejtuese. Andaj deri në një klasifikim tjetër në kuptim të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pozita e ankuesit konsiderohet pozitë e kategorisë së ulët drejtuese, e si rezultat i kësaj,

është në përgjegjësinë e Ministrisë së Shëndetësisë që në kuptim të dispozitave ligjore të bëjë klasifikimin e pozitave përkatëse brenda kësaj ministrie, në këtë rast pretendimi i ankuesit nuk gjen mbështetje ligjore.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Inspektorët Sanitar trajtohen ndryshe me paga nga Inspektorët Farmaceutik dhe Inspektorët Shëndetësor dhe kjo nuk është trajtuar në mënyrë ligjore dhe janë shkelur parimet ligjore, Kolegji i Këshillit, ka marr si mostra akt emërimit për pozitën Inspektor Sanitar, Inspektor Farmaceutik dhe Inspektor Shëndetësor, e sipas akt emërimeve rezulton se pozita Inspektor Sanitar, është klasifikuar sipas Klasës dhe koeficientit I11 apo me koeficientin shtatë (7), ndërsa Inspektor Farmaceutik dhe Inspektor Shëndetësor është klasifikuar sipas klasës dhe koeficientin shtatë pikë katër (7.4). Lidhur me këtë pretendim, Kolegji i Këshillit ju referuar Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, respektivisht sipas Shtojcës Nr. 9, pozita Inspektorë shëndetësor dhe farmaceutik është paraparë sipas Klasës H10 dhe koeficientin 7.4, ndërsa pozita Inspektor Sanitar nuk është paraparë sipas kësaj shtojce, por e njëjtë hyn në kuadër të Shtojcës Nr.10.6, konkretisht tek pozitat Inspektor me Klasë I11 dhe koeficient 7, ndërsa sipas nenit 33 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, është përcaktuar se: *“1. Rritet koeficienti i pagës për një (1) njësi për të gjitha klasat e pozitave sipas Shtojcave 1 - 15 të Ligjit nr. 08/L-196 të Pagave në Sektorin Publik. 2. Rritja sipas paragrafit 1 të këtij neni, aplikohet në dy faza, me rritje prej zero pikë pesë (0.5) njësi të koeficientit duke filluar nga muaji janar 2025, ndërsa rritja tjetër prej zero pikë pesë njësi (0.5) aplikohet nga muaji korrik 2025”*, atëherë njësia e koeficientit është rritur për 0.5 nga muaji janar dhe 0.5 nga muaji korrik, në këtë rast paga koeficienti për pozitën Inspektor Sanitar tashmë është tetë (8), ndërsa për pozitën Inspektor Farmaceutik dhe Inspektor Shëndetësor koeficienti tashmë është tetë pikë katër (8.4), rrjedhimisht në këtë drejtim pretendimet e ankuesit nuk janë të bazuar për shkak që koeficientët janë të përcaktuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe shtojcave të këtij ligji.

Sa i përket pretendimit të ankuesit për zbatimin e shtesës prej 250 Euro në mënyrë retroaktive nga janari 2024, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas shkresave të lëndës, respektivisht përmes kërkesës për miratimin e shtesave në pagë me numër protokoll 05-3901 të datës 22.05.2025, Ministria e Shëndetësisë ka dërguar për Komisionin për Kushte të Tregut të Punës në Ministrinë e Financave, duke kërkuar që të plotësohet dhe ndryshohet vendimi Nr. 34/2023 i datës 30.08.2023, ndërsa Komisioni për Kushte të Tregut të Punës i Ministrisë së Financave, më datë 02.02.2026, ka nxjerr Rekomandimin me Nr. 01/2026, me të cilin i rekomandon Ministrinë të Ministrisë së Financave, që të shfuqizoj Vendimin Nr. 34/2023 të datës 30.08.2023, të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se në këtë fazë të procedurës nuk ka vendim të nxjerr nga Ministri i Ministrisë së Financave sipas rekomandimit të cekur më lartë të Komisioni për Kushte të Tregut të Punës, andaj duke qenë se sipas Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, është përgjegjësi e komisionit përkatës është të përgatis rekomandimin dhe të propozoj Ministrinë përgjegjëse për Financa të nxjerr vendim, dhe përderisa nuk ka vendim nga Ministri i Ministrisë së Financave, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk mund të trajtoj çështjen në mënyrë meritore për shkak që palët e pakënaqura ndaj vendimit të Ministrisë së Financave kanë të drejtë ankesë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, në këtë kontekst pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, për kompensimin e orëve shtesë të realizuara, Kolegji i Këshillit, sipas provave të lëndës, konstaton se sipas listave të bashkëngjitura në lëndë për Inspektorët

Sanitar në Regjionin e Prizrenit, Gjiçanit, Pejës, Ferizajt, Mitrovicës dhe Prishtinës, dhe sipas këtyre listave nuk është emri i ankuesit, kështu që në këtë rast sipas Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensimin për Kujdestari, Punën Gjatë Natës dhe Punën Jashtë Orarit të Punës, janë përcaktuar llojet e kompensimeve, procedurat e miratimit të kompensimit për punën jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës. Në këtë rast Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse ankuesi nuk është pjesë e listave sipas regjioneve të cekura më lartë, atëherë i njëjti kërkesën e parashtruar e ka për nëpunësit të tjerë në kuadër të Inspektoratit Sanitar, kështu që ankuesi në këtë rast kërkesë apo ankesë mund të parashtroj vetëm sa i përket elementeve të tij të marrëdhënies së punës, ndërsa në rastin tjetër kërkesat apo ankesat adresohen nga nëpunësit që pretendojnë që po ju cenohet një e drejtë nga marrëdhënia e punës apo nga përfaqësuesi që të njëjtit e autorizojnë, e për rrjedhojë, ankuesi nuk ka legjitimitetin e palës për të kërkuar një të drejtë për nëpunësit e tjerë, kështu që ndërlidhur me këtë pretendim ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës mund të parashtroj nëpunësi civil apo përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar siç parashihet me nenin 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar për shkak që i njëjti nuk ka legjitimitet të palës në këtë aspekt siç parashihet me nenin 14 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.672/2026, më datë 23/07/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit I.T;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së;